

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Kufizimet e të drejtës për informim

E drejta për informim është një e drejtë e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në nenin 23 në Kreun "Liritë dhe të Drejtat e Njeriut". Megjithatë, e drejta për informim nuk është një e drejtë absolute por një e drejtë relative e cila kufizohet specifikisht nga neni 17 i Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

E drejta për informim mund të kufizohet nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private, sekretin tregtar, të drejtën e autorit, patentat nëse subjekti i të dhënave nuk ka dhënë pëlqimin; sigurinë kombëtare, parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor, mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike publike për zhvillimin e politikave publike, mbarëvajtjen ndërkombëtare ose qeveritare, vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm.

Në këto rrethana, autoriteti publik duhet të marrë në konsideratë nëse do të ishte në "interesin publik" që informacionin të jepet. Nëse përfitimi në publik është më i madh se dëmi për autoritetin apo njerëz të tjerë të prekur, autoriteti duhet të jap informacionin.

Autoriteti Publik mund të refuzojë informacionin e klasifikuar sekret shtetëror vetëm pasi të ketë filluar procedurën e rishikimit. Vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të informacionit mund të vendosë për trajtimin e kërkesës për informacion.

Nëse vetëm një pjesë e informacionit të kërkuar preket nga kufizimet, autoriteti publik jep informacionin duke treguar qartë pjesët e dokumentacionit që janë refuzuar.

Nëse autoriteti vendos të refuzojë kërkesën për informacion refuzimi duhet shkruar dhe duhet të shpjegohet.

Përmbledhje mujore e vendimeve

Vendim nr. 38 -

Informacioni që mbahet nga autoriteti publik dhe nuk kufizohet duhet ti jepet kërkuarit

Vendim nr. 39 -

Nëse kufizimi prek një pjesë të informacionit pjesa tjetër nuk refuzohet

Vendim nr. 40 -

Autoritetet Publike duhet të japin me saktësi informacionin e kërkuar


Vendimarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit shtator, ka dhënë 3 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI). Të gjitha vendimet kanë qenë vendime urdhërimi ndaj autoriteteve publike për të dhënë informacionin e kërkuar.

Me anë të Vendimit nr. 38 datë 21.09.2020 Zyra e Komisionerit ka pranuar ankesën e gazetarit M.B i cili i kërkonte Bashkisë Fier (Autoriteti Publik) informacion mbi:

"Numrin e personave me aftësi ndryshe (të kufizuar) të punësuar si dhe ata të shkarkuar në administratën e autoritetit publik duke filluar nga viti 2015; Numri i fasonerive që operojnë me mbi 100 punonjës aktualisht në Fier; Nr. i përfaqësueve të komunitetit ROM në Këshillin Bashkiak të qytetit; Nr. e pakove ushqimore të shpërndarë nga Autoriteti Publik gjatë masave kufizuese si shkak i pandemisë "Covid-19"; Nr. i pajisjeve elektronike dhe çfarë lloji u dhuruan nga Autoriteti Publik për nxënësit gjatë pandemisë "Covid-19". Në cilën fazë ndodhet projekti për ndërtimin e kompleksit stërvitor në Darzezë për fazat përgatitore."

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerësoi në parim informacioni/ dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".



**TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES**

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Njësitë e vetëqeverisjes vendore e kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar. Konkretisht, neni 15 "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore", parashikon se:

"1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.

2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike..."

Komisioneri vlerëson se, ekzistenca e informacionit /dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, gjatë vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Në përfundim KDIMDP vendosi Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimin në faqen e KDIMDP www.idp.al.

TË NJOHIM KOORDINATORËT E TË DREJTËS PËR INFORMIM MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Emër Mbiemër: Etleva Shore

Funksioni: Juriste

Drejtoria: Drejtoria e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Autoriteti Publik: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Data e emërimit si koordinator: shtator 2018

Eksperiencia të mëparshme si koordinator për të drejtën e informimit: Jo

Email: etleva.shore@infrastruktura.gov.al

Nr. telefonit: 0682001225

Numri i kërkesave për informacion të regjistruar gjatë vitit 2020: 100 kërkesa për informacion

Si e vlerësoni nivelin e transparencës së autoritetit publik ku ju punoni? Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në çdo kërkesë për informacion të paraqitur, ka ndjekur parashikimet ligjore si në rastet kur nuk e disponon informacionin apo dokumentacionin e kërkuar, duke e njoftuar kërkuuesin brenda afateve ligjore, si dhe në rastet kur informacioni apo dokumentacioni zotërohet, duke ia vënë në dispozicion dokumentin original ose kopjen e tij, në formën dhe formatin e kërkuar. MIE ka publikuar në faqen e saj zyrtare www.mie.gov.al programin e transparencës në të cilin janë pasqyruar informacionet dhe dokumentat që bëhen publike pa kërkesë, si dhe regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim. Autoriteti Publik që unë përfaqësoj në kuadër të së drejtës për informim, i është përgjigjur pothuajse të gjitha kërkesave për informacion brenda kompetencave dhe fushës së përgjegjësi që mbulon.

Cila është vështirësia më e madhe që hasni në detyrën tuaj si koordinator për të drejtën e informimit? Detyra e koordinatorit për të drejtën e informimit nuk është një detyrë e lehtë. Marrja përsipër e një detyre të tillë kërkon në rradhë të pare përgjegjshmëri për të trajtuar çdo kërkesë me integritet dhe me gadishmëri për transparencë duke synuar realizimin sa më të plotë të së drejtës për informim të çdo kërkuesi. Një nga sfidat më të mëdha për mua gjatë kryerjes së këtij funksioni është fakti se për shkak të fushës së gjërë të përgjegjësisë që MIE mbulon në veprimtarinë e saj, është i vështirë procesi i koordinimit me strukturat përgjegjëse në mënyrë që informacioni i kërkuar të mund të dërgohet brenda afateve ligjore. Dëshiroj të theksoj se gjatë periudhës së pandemisë (sidomos gjatë karantinës) ky proces ka qënë akoma edhe më i vështirë për tu realizuar sipas kuadrit ligjor.

Cili është sugjerimi juaj për përmirësim në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit?

Sugjerimi im modest në lidhje me ligjin për të drejtën e informimit lidhet me dispozitat që parashikojnë rastet e kufizimit të së drejtës për informim, të cilat mendoj që duhen riparë në drejtim të sqarimit më specifik të rasteve të kufizimit të së drejtës për informim. Për këtë qëllim, si dhe për shumë raste të tjera specifike të konstatuara gjatë praktikës mendoj se nxjerra e një VKM-je në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit do të ishte më efektive.

Lidhur me statusin e koordinatorit për të drejtën e informimit sugjeroj që koordinatori duhet të gëzojë një status të veçantë (mëvetësishëm) brenda autoritetit publik në mënyrë që personi që kryen këtë funksion të ndihet i motivuar në realizimin e kompetencave që i jep ligji për të drejtën e informimit.

28 shtatori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim Right to Know Day

Dita Ndërkombëtare e të Drejtës për Informim kremtohet çdo vit në të gjithë botën. Kjo ditë u vendos në përfundim të Konferencës “Për lirinë e informimit”, e zhvilluar në Sofje të Bullgarisë, në 26-28 shtator 2002.

Informacioni është një e drejtë themelore e njeriut dhe gur themeli për formimin e institucioneve demokratike.

NELSON MANDELA

Asnjë nga çështjet kryesore me të cilat përballet njerëzimi nuk do të zgjidhet pa aksesin në informacion.

CHRISTOPHE DELOIRE,
SEKRETARI I PËRGJË TË THSHËMËTARËVE
I REPORTERËVE PA KUFË

Mungesa e transparencës sjell mosbesim dhe një ndjenjë të thellë pasigurie.

DALAI LAMA

Ligji për të Drejtën e Informimit duhet të administrohet me një supozim të qartë: Përballë dyshimit, mbizotëron transparenca.

BARACK OBAMA

Të mësuarit është një përvojë. Çdo gjë tjetër është thjesht informacion.

ALBERT EINSTEIN

28 SHIATOR
28 SHIATOR
28 SHIATOR
28 SHIATOR

DITA E TË DREJTËS PËR INFO
INFORMACIONI ËSHTË P
WWW.IDP

E VËRTETA ASNJËHERË NUK E DËMTON
NJË KAUZË TË DREJTË.

INFORMACIONI ËSHTË 26 JANAR

TË MËSURRIT ËSHTË EKSPERIENCË.
EDO SËJË TJETËR ËSHTË INFORMACION.

ITUNGËSI E TRANSPARENÇËS
DHE NJË NJËNË TË THE

TRANSPARENÇA ËSHTË E DREJTË PËR INFORMACION,
NDËRSA HAPJA ËSHTË E DREJTË PËR PJESEMARRJE.

NDËRSHTËMËRIA DHE TR
JU BËJNË TË DËRËSHMËT
JINI TË NDËRSHTËM DHE

WWW.IDP.AL